



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

KOMISIONI QENDROR ZGJEDHOR

01.04.2021

**ZGJEDHJET STUDENTORE 2021 – NJOFTIM PUBLIK PËR
STUDENTËT**

Njoftohen Organizatat Studentore se listat e kandidatëve për zgjedhjet studentore për Parlament dhe këshilla të studentëve mund të dorëzohen deri më 02.04.2021 në ora 14:00. Për paraqitjen e listës së kandidatëve duhet të shfrytëzoni formularin i cili është publikuar në ueb faqe të umib.net.

Lista e kandidatëve duhet të përmbajë të dhënat sikurse kërkohet në nenin 24 pika 2 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, kurse për kandidatët e nominuar duhet të ofrohen të dhënat sikurse kërkohet në nenin 25 pika 3 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë. Lista e kandidatëve e Organizatave Studentore duhet të përbëhet prej maksimum, sa dyfishi i mandateve të lejueshme që të zgjidhet një organ, në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet e studentëve. Kandidatët tepricë do të hiqen prej listës nga KQZ.

Në pajtim me Statutin e Universitetit dhe Rregulloren për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, Parlamenti përbëhet nga 11 anëtarë, kurse në bazë të numrit të studentëve me të drejtë vote Këshillat e studentëve nëpër fakultete do të kenë këtë numër të anëtarëve: FGJ – 5; FTU – 5; FIMK – 7; FJ – 5; FE – 5 dhe FEd – 7 anëtarë.

Kandidatët e paraqitur në lista duhet të deklarojnë me nënshkrimin e tyre pajtueshmërinë me kandidaturën.

Gjatë përcaktimit të kandidatëve – hartimit të listave keni parasysh nëse kandidatët e propozuar nuk bien ndesh me nenin 3 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë.

Te dhënat e kandidateve në formular duhet të plotësohen me shkronja të mëdha, dhe për këtë të shfrytëzohet formulari në excel i përbashkët.

Lista e kandidatëve dërgohet edhe në formën elektronike në email adresën: ermira.sopa@umib.net



Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1